

# Bllokada në Kuvendin e Kosovës

dhe cenimi i integritetit  
institucional



Instituti Demokratik I Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

**COPYRIGHT © 2025. Kosova Democratic Institute (KDI).**

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +383 (0) 38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Dizajni: **envinion**

**Shënim:** Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Të rinjtë dhe Shoqëria Civile për Integritet" (Eng: Youth and Civil Society for Integrity), i cili financohet nga Qeveria Suedeze, përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe jo doemos reflekton qëndrimet e donatorit.



# TABELA E PËRMBAJTJES

**06**

PËRMBLEDHJE  
EKZEKUTIVE

**07**

1. KUVENDI SI GARANT  
I FUNKSIONALITETIT  
DEMOKRATIK DHE  
INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

**09**

2. NGECJET NË ZBATIMIN E  
REFORMAVE, LEGJISLACIONIT  
DHE MARRËVESHJEVE  
NDËRKOMBËTARE

**15**

3. MUNGESA  
E KONTROLLIT  
PARLAMENTAR MBI  
VEPRIMET E QEVERISË

**19**

4. CENIMI I INTEGRITETIT  
DHE FUNKSIONIMIT  
TË INSTITUCIONEVE TË  
PAVARURA DHE BORDEVE  
PUBLIKE

**23**

PËRFUNDIME DHE  
REKOMANDIME



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kriza politike që po zgjat tashmë mbi tre muaj ka bllokuar funksionimin e njëres prej shtyllave kryesore të rendit kushtetues – Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mungesa e kompromisit politik dhe shpërfillja e interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese për konstituimin e tij po cenojnë integritetin institucional dhe kanë paralizuar funksionimin e arkitekturës shtetërore, rrjedhimisht kontrollin dhe balancën mes pushteteve. Kjo situatë ka krijuar një vakum, duke i mundësuar një qeverie në dorëheqje të veprojë përtej mandatit të saj – duke miratuar mbi 60 akte me me vlerë financiare mbi 70 milionë euro – në mungesë të kontrollit demokratik dhe pa transparencën e duhur.

Kjo situatë ka shtuar rrezikun e vendimmarrjeve arbitrare, keqpërdorimeve të fondeve publike dhe ka cenuar pavarësinë e institucioneve dhe bordeve që ligjërisht janë nën mbikëqyrjen e Kuvendit. Për më tepër, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë shpërfillur në mënyrë të përsëritur, duke rrezikuar që moszbatimi i normave kushtetuese të normalizohet si sjellje politike. Kur vendimmarrësit nuk përballen me pasoja për shkeljet kushtetuese, respektimi i Kushtetutës fillon të perceptohet si opion politik dhe jo si detyrim i padiskutueshëm. Kjo minon ndarjen e pushteteve dhe deformon sjelljen institucionale, duke i kthyer institucionet nga garantues të interesit publik në instrumente të vullnetit politik të momentit. Në këtë mënyrë dobësohet besimi i qytetarëve në funksionimin e rendit kushtetues dhe dëmtohet kultura demokratike e vendit.

Në planin e jashtëm, kjo krizë ka cenuar kredibilitetin dhe imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Bllokimi i Kuvendit ka lënë pezull disa marrëveshje ndërkombëtare dhe reforma të nevojshme për integrimin evropian, duke përfshirë zbatimin e Planit të Rritjes së BE-së me vlerë mbi 800 milionë euro. Në të njëjtën kohë janë bllokuar ose vonuar dhe marrëveshje të tjera me FMN, Bankën Botërore dhe me iniciativa që rrjedhin nga Procesi i Berlinit.

Përveç të gjitha pasojave institucionale dhe politike, një nga pasojat më të nënvlerësuara të bllokadës institucionale është privimi i qytetarëve nga përfaqësimi i tyre politik. Moskonstituimi i Kuvendit i ka lënë qytetarët pa përfaqësim, duke i privuar nga e drejta për të pasur një forum demokratik ku mund të artikulojnë interesat dhe shqetësimet e tyre përmes deputetëve të zgjedhur.

Një tjetër vendim me rëndësi është ai i 26 qershorit 2025, me të cilin Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar që Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve, pra deri më 26 korrik 2025. Ky vendim thekson qartë se zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkrjetarëve të Kuvendit është parakusht për fillimin e funksionimit të tij si organ ligjvënës dhe vendimmarrës. Deri më sot, ky detyrim nuk është përmbushur, ndërkohë që afati kushtetues po afrohet me shpejtësi. Edhe pse Gjykata nuk ka përcaktuar sanksione të drejtpërdrejta për mosrespektimin e afatit, shpërfillja e tij përbën shkelje të nenit 116 të Kushtetutës, sipas të cilit vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Bllokimi aktual është kryekëput rezultat i mungesës së vullnetit politik. Në këtë frymë, është jetike që Kuvendi të konstituohet sa më parë për të rikthyer funksionalitetin e institucioneve, për të mbrojtur rendin kushtetues dhe për të rikthyer besimin e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë në institucionet e Kosovës.



# KUVENDI SI GARANT I FUNKSIONALITETIT DEMOKRATIK DHE INTEGRITETIT INSTITUCIONAL





2

**Në themel të rendit kushtetues të Kosovës qëndron parimi i ndarjes së pushteteve dhe i kontrollit e balancit mes tyre, siç përcaktohet qartë në nenin 4 të Kushtetutës. Shteti funksionon mbi tri pushtete të ndara – legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori – ku secili ka kompetenca të përcaktuara dhe kontrollohet reciprokisht nga të tjerët.**

Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë ligjvënës dhe përfaqësues (neni 63 i Kushtetutës), i cili shpreh drejtpërdrejt sovranitetin e popullit dhe ushtron pushtetin legjislativ në përputhje me parimet demokratike. Megjithëse ligjvënësia nuk është funksioni i vetëm i Kuvendit, ajo mbetet kompetenca e tij kryesore dhe e pazëvendësueshme.

Në këtë kuadër, procesi legjislativ, që përfshin nismën, shqyrtimin, miratimin, dekretimin dhe publikimin e ligjeve, është themeli i punës së Kuvendit. Qeveria është e detyruar të zbatojë ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe nuk ka asnjë hapësirë për të shmangur këtë detyrim. Ky raport pasqyron logjikën kushtetuese që i ndan qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve.

Përveç funksionit ligjvënës, Kuvendi luan një rol qendror si garant i reformave dhe integritetit institucional të vendit. Si institucion që formon dhe mban përgjegjëse Qeverinë, Kuvendi ka kompetenca të gjera për të siguruar që politikat e ekzekutivit të jenë në përputhje me interesin publik dhe normat ligjore.

Neni 97 i Kushtetutës përcakton përgjegjësinë politike të Qeverisë ndaj Kuvendit, duke i dhënë këtij të fundit të drejtën të mbikëqyrë, të informohet dhe të kërkojë llogari nga Qeveria pa kufizime kohore apo tematike. Ky mekanizëm e bën Kuvendin një instrument jetik për kontrollin e ekzekutivit dhe për mbrojtjen e ndarjes së pushteteve.

Kuvendi gjithashtu ka një rol të veçantë në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare. Si institucion i cili miraton ligje dhe ratifikon marrëveshje ndërkombëtare, Kuvendi është porta përmes së cilës Kosova harmonizon legjisllacionin e saj me standardet e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Kjo e vendos atë në qendër të reformave të nevojshme për integrimin evropian dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Një nga funksionet tjera themelore të Kuvendit është edhe përfaqësimit politik i qytetarëve. Si organi më i lartë përfaqësues, Kuvendi është i vetmi forum ku sovraniteti i popullit artikullohet dhe ushtrohet përmes deputetëve. Në mungesë të tij, qytetarët mbeten pa një mekanizëm institucional për të ndikuar në vendimmarrje, për të adresuar shqetësime dhe për të kërkuar llogari. Ky boshllëk jo vetëm që dobëson lidhjen midis shoqërisë dhe shtetit, por gjithashtu zvogëlon legjitimitetin e politikave të ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

**NGECJET NË ZBATIMIN E REFORMAVE, LEGJISLACIONIT DHE MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**





## Moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës ka paralizuar procesin ligjvënës dhe zbatimin e reformave strategjike. Sipas përcaktimeve ligjore dhe procedurale, çdo iniciativë ligjore që ndodhej në procedurë parlamentare, goftë në lexim të parë, në lexim të dytë, apo edhe vetëm e dorëzuar për shqyrtim, kthehet automatikisht tek propozuesi, nuk bartet në legjislaturën e re dhe në mënyrë që hyjë në procedurë sërish, duhet të parashtrohet që nga fillimi. Kjo nënkupton që secila nga këto iniciativa duhet të procedohet në procedurë parlamentare nga pika zero – një proces që zgjatë mesatarisht 3 deri në 6 muaj.

Si pasojë e vonesave me konstituimin e Kuvendit, disa reforma<sup>1</sup> kyçe, po preken drejtpërdrejt për shkak të mungesës së kapaciteteve vendimmarrëse. Pavarësisht se është një procedurë standarde që iniciativat ligjore kthehen te propozuesi pas përfundimit të mandatit të një legjislatore, vonesat aktuale po e shtyjnë tej mase rifillimin e tyre. Kjo vlen sidomos për nisma të rëndësishme si Vettingu dhe paketa e ligjeve për Reformën në Drejtësi, apo Kodi Civil, të cilat, megjithëse kishin kaluar një pjesë të konsiderueshme të procedurave parlamentare – përfshirë shqyrtimin në komisione dhe konsultimet publike – tani duhet të procedohen sërish nga fillimi, duke e humbur kohën dhe përparimin tashmë të arritur. Rreziku kryesor është që, përveç vonesave të mëdha, disa nga këto iniciativa mund të humbasin momentumin politik ose të mos jenë në mesin e prioritetëve të agjendës së re legjislative.

Moskonstituimi i Kuvendit ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në procesin e rishikimit të buxhetit aktual si dhe në planifikimin dhe aprovimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Kjo do të impononte një situatë delikate financiare, e cila do të anashkalonte vendosjen e mirëfilltë të prioritetëve buxhetore që përkohë me nevojat reale dhe zhvillimore të vendit.

Edhe marrëveshjet ndërkombëtare janë të ekspozuara ndaj ndikimit të moskonstituimit. Marrëveshjet ndërkombëtare kanë mbetur pa u ratifikuar, ndërsa edhe pas konstituimit, përderisa nuk formohet një Qeveri e re me mandat të plotë, ato nuk mund të procedohen për miratim.



### 2.1 Bllokimi i Reformës dhe Ligjeve Kritike në Drejtësi

Pakaja e ligjeve të reformës në drejtësi përfshin disa iniciativa kryesore që mbeten të bllokuara për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit. Këto ligje synojnë të forcojnë sistemin e drejtësisë dhe të rrisin llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve. Funkcionimi i Kuvendit është i domosdoshëm jo vetëm për të miratuar këto akte mbi bazën e të gjitha rekomandimeve dhe vërejtjeve që janë paraqitur nga ana e Komisionit të Venecias, por edhe për të nisur fazën e mbikëqyrjes së zbatimit të tyre në praktikë.

#### VETTINGU

Amendamentet kushtetuese për vettingun, të miratuara nga Qeveria dhe prej dhjetorit 2024 në pritje të miratimit në Kuvend, kanë mbetur të bllokuara për shkak të mungesës së konsensusit politik mes shumicës shqiptare dhe përfaqësuesve të komuniteteve jo-shumicë, në veçanti atij serb.

Vettingu është më shumë se një procedurë teknike, meqë synon të pastrojë sistemin e drejtësisë nga individët me integritet të kompromentuar, duke forcuar besimin publik në gjyqësor, rritur transparencën dhe duke e bërë më efikas trajtimin e rasteve gjyqësore.

<sup>1</sup> Ndonëse gama e projektligjeve dhe akteve tjera që janë në funksion të reformave sistematike është e gjerë dhe mbulon edhe shumë fusha tjera me rëndësi, për qëllime të këtij punimi, fokusi është vënë tek reformat në sektorin e drejtësisë – të cilat janë në funksion të rritjes së integritetit institucional dhe luftës kundër korrupsionit.



#### KODI CIVIL

Një tjetër ligj i rëndësishëm që mbetet i pezulluar është Kodi Civil, i cili është themelor për sigurinë juridike, të drejtat civile dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Vonesat e mëtejshme rrezikojnë të minojnë të gjithë procesin, duke e detyruar të nisë nga e para dhe duke krijuar pasiguri për qytetarët dhe investitorët.<sup>2</sup> Kjo pasiguri dëmton edhe përpjekjet e Kosovës për integrim në tregun evropian, ku përputhja e legjislatimit civil është një nga kriteret bazë.

#### PROJEKTIGJET TJERA TË REFORMËS NË DREJTËSI

Pesë projektligje që përbëjnë Deklaratën e Përbashkët të Zotimeve për Reformën në Sistemin e Drejtësisë janë të bllokuara, pavarësisht se janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni i Venecias.

Këto projektligje – për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarët dhe Prokurorët; për Këshillin Gjyqësor; për Këshillin Prokurorial; për Kontrollin e Integritetit, Statusin dhe Vlerësimin e Performancës për Gjyqtarët dhe Prokurorët; për Akademien e Drejtësisë – adresojnë dobësitë strukturore që kanë penguar llogaridhënien dhe kanë mundësuar abuzime brenda sistemit të drejtësisë. Pa to, sistemi i drejtësisë mbetet i ekspozuar ndaj ndikimeve politike dhe i paaftë të imponojë standarde të larta profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët.



### 2.2 Rrezikimi i rishikimit dhe planifikimit të buxhetit të shtetit

Një tjetër pasojë serioze e moskonstituimit të Kuvendit është pamundësia për të miratuar rishikimin e buxhetit për vitin 2025 dhe për të përgatitur buxhetin e vitit 2026. Rishikimi i buxhetit, i cili zakonisht ndodh në mes të vitit, është një proces i domosdoshëm për të reflektuar nevojat reale dhe ndryshimet që ndodhin gjatë vitit fiskal. Në mungesë të tij, dhjetëra kërkesa të institucioneve dhe komunave mbeten

të paadresuara, duke penguar shërbimet dhe investimet e planifikuara.<sup>3</sup>

Për më tepër, në rast të zvarritjes së mëtutjeshme të bllokadës në Kuvend, përgatitja e buxhetit për vitin 2026 pritet të bëhet nga një qeveri në detyrë, pa legjitimitetin e plotë politik dhe pa mbështetjen e Kuvendit. Ky proces, që zakonisht kërkon një dialog të gjerë institucional dhe publik, e humbet bazën e tij demokratike dhe rrit rrezikun që prioritetet të vendosen në mënyrë arbitrare.



### 2.3 Bllokimi i ratifikimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare

Ngjashëm, mungesa e Kuvendit ka bllokuar ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë implikime të drejtpërdrejta për ekonominë, besueshmërinë dhe përfshirjen e Kosovës në proceset rajonale dhe evropiane. Këto marrëveshje nuk janë thjesht dokumente formale, por përfaqësojnë investime konkrete, mundësi për reforma dhe mesazhe politike për partnerët ndërkombëtarë se Kosova është një aktor serioz.

#### RREZIKOHEN PËRFITIMET NGA PLANI I RITJES I BE-SË

Mosmiratimi i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, një instrument i rëndësishëm financiar i Bashkimit Evropian që pritet t'i sjellë Kosovës mbi 800 milionë euro deri në vitin 2027,<sup>4</sup> është një indikator i qartë i kostos ekonomike që Kosova mund t'a vuajë nga vazhdimi i bllokadës institucionale. Disbursimi i mjeteve në kuadër të këtij instrumenti është i kushtëzuar me miratimin e marrëveshjes me Komisionin Evropian nga Kuvendi i Kosovës, gjë që po pamundësohet për shkak të krizës institucionale.

Deri tani, qeveria në detyrë ka deklaruar se arsyeja pse marrëveshja nuk është ratifikuar brenda afatit të paraparë është se vetë Komisioni Evropian nuk i është përmbajtur afateve që ka vendosur.<sup>5</sup> Ndërsa, vlen të theksohet se

<sup>2</sup> Portali Kallxo. Com, 7 shkurt 2025, <https://kallxo.com/lajm/kodi-civil-sfide-per-legjislaturen-e-re-partite-per-dhe-kunder-martesave-mes-personave-te-gjinise-se-njeite/>; i qasur më 8 korrik 2025.

<sup>3</sup> Kosova Press, "Harrohet rishikimi i buxhetit për vitin 2025, ngërçi politik rrezikon edhe atë për 2026-n", 13 maj 2025, në <https://kosovapress.com/harrohet-rishikimi-i-buxhetit-per-vitin-2025-ngerci-politik-rrezikon-edhe-ate-per-2026-n>

<sup>4</sup> Dukagjini, "882.6 Milionë euro nga plani i rritjes "Peng" i zhbllokimit të Kuvendit", 24 maj 2025, në <https://www.dukagjini.com/882-6-milione-euro-nga-plani-i-rritjes-peng-i-zhbllokimit-te-kuvendit/>





aftësia e Legjislaturës së kaluar për të ratifikuar me kohë këtë marrëveshje ka qenë e kufizuar, duke marrë parasysh faktin se Qeveria në detyrë nuk kishte arritur të sigurote votat e nevojshme për të ratifikuar edhe 6 marrëveshje ndërkombëtare të cilat mbeten në procedurë për muaj të tërë në Kuvend.

Edhe pse ende nuk ka ndonjë sinjal të qartë nëse BE do të penalizojë Kosovën për vonesa në ratifikimin e marrëveshjes nga Plani i Rritjes, situata nuk është pa pasoja. Mungesa e ratifikimit jo vetëm që vonon fillimin e reformave të planifikuara, por e paraqet Kosovën si një partner të paqëndrueshëm dhe rrezikon të minojë besueshmërinë e

saj në proceset integruese dhe në marrëdhëniet me BE-në. Për më tepër, çdo ditë që humbet pa e zhblokuar këtë proces është një ditë më pak për të nisur reformat që janë pjesë e Planit të Rritjes, përfshirë në fushat si sundimi i ligjit, konkurrueshmëria, zhvillimi i qëndrueshëm dhe integrimi rajonal.

**RREZIQET NGA MOSMIRATIMI I MARRËVESHJEVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE**

Gjatë legjislaturës së kaluar, gjashtë marrëveshje të tjera ndërkombëtare mbetën të paaprovuara për muaj të



tërë për shkak të mungesës së shumicës parlamentare. Këto marrëveshje përfshijnë, ndër të tjera, një program zhvillimor që synon përmirësimin e efektivitetit fiskal, rritjen e konkurrueshmërisë dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Po ashtu, njëra nga marrëveshjet lidhet me financimin e projektit për energjinë diellore në KEK, pjesë e përpjekjeve për tranzicion të qëndrueshëm energjetik. Ndërkaq, disa marrëveshje të tjera kanë të bëjnë me aderimin e Kosovës në konventa ndërkombëtare që lehtësojnë bashkëpunimin juridik në çështje civile dhe tregtare, duke forcuar kështu infrastrukturën ligjore ndërkombëtare të vendit.

Përtej vlerës së tyre individuale, këto marrëveshje janë të lidhura ngushtë me prioritetet kyçe të shtetit, nga stabiliteti makrofiskal dhe energjia e pastër, te funksionimi efektiv i sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Vonesat e zgjatura në ratifikimin e tyre jo vetëm që e shtojnë përpara zbatimin e këtyre reformave, por edhe dëmtojnë ritmin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Për më tepër, nëse procesi i ratifikimit vazhdon të mbetet i bllokuar, mbetet e paqartë nëse institucionet partnere që kanë negociuar dhe nënshkruar këto marrëveshje vazhdojnë të qëndrojnë prapa tyre me të njëjtin nivel angazhimi.





Në tetor 2024, Kosova nënshkroi dy marrëveshje të tjera në kuadër të Procesit të Berlinit – Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM) dhe marrëveshjen për përmirësimin e qasjes në arsimin e lartë<sup>6</sup> – të cilat gjithashtu kërkojnë ratifikim.

Të dy dokumentet janë pjesë e agjendës rajonale për bashkëpunim dhe integrim më të thelluar në fusha kyçe si ekonomia, tregu i punës dhe arsimit. Ndër to, marrëveshja për përmirësimin e qasjes në arsimin e lartë kërkon ratifikim në Kuvendin e Kosovës për të hyrë në fuqi. Sa i përket Planit të ri të Veprimit për TBR, ndonëse nuk është e qartë nëse zbatimi i tij kërkon procedurë ratifikimi, por në çdo rast, mbikëqyrja parlamentare mbetet thelbësore për të dyja marrëveshjet.

Vonesat në përmbylljen e këtyre proceseve jo vetëm që shtyjnë përpara reformat e planifikuara, por edhe rrezikojnë të dërgojnë sinjal tek partnerët se Kosova nuk ka vullnet të mjaftueshëm për t'i çuar përpara angazhimet e saj ndërkombëtare.

### 2.4 Pasojat në zbatimin e afateve dhe vendimeve kushtetuese

Zvarritja në konstituimin e Kuvendit të Kosovës po ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e institucioneve për të zbatuar vendime të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese, duke prodhuar pasoja politike, juridike, financiare dhe shoqërore. Edhe pse moszbatimi i disa prej këtyre vendimeve daton në legjislaturën paraprake, mungesa e vendimmarrjes efektive po e zgjat tej mase vakuumin institucional dhe po rrezikon të krijojë një praktikë ku vonesat në zbatim të Kushtetutës perceptohen si të pranueshme për arsye politike.

Një rast ilustrues është vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Pagat në sektorin publik, që ka obliguar Kuvendin të ndërmarrë harmonizimin ligjor brenda një afati gjashtëmuor – afat që ka skaduar më 24 gusht 2024. Për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit, ky detyrim kushtetues mbetet ende i papërbushur. Si rrjedhojë, mijëra zyrtarë publikë kanë paralajmëruar padi për rimbursim të shtesave të papaguara, çka mund t'i sjellë shtetit një barrë financiare deri në 40 milionë euro.

<sup>6</sup> Radio Evropa e Lirë. "Liderët e Ballkanit Perëndimor nënshkruajnë marrëveshje të reja në Berlin", 14 tetor 2024, në <https://www.evropalire.org/a/lideret-e-ballkanit-perendimor-nenshkruajne-marreveshje-te-reja-ne-berlin/33158156.html>



# MUNGESA E KONTROLLIT PARLAMENTAR MBI VEPRIMET E QEVERISË








## Moskonstituimi i Kuvendit ka lënë Qeverinë në dorëheqje<sup>7</sup> të veprojë pa mbikëqyrje institucionale, e cila ka vazhduar t'a shfrytëzuar këtë vakum për të marrë vendime politike dhe financiare jashtë kufizimeve të përcaktuara nga Ligji për Qeverinë.

Gjatë periudhës 27 mars– 14 korrik 2025, Qeveria ka miratuar 14 akte nënligjore dhe mori 50 vendime të tjera, me një vlerë totale financiare prej 71,502,712.93 eurosh.<sup>8</sup>

Megjithatë, ato nuk u shoqëruan me konsultim publik ose debat institucional. Mungesa e Kuvendit ka krijuar një mjedis ku vendimmarrja bëhet pa transparencë dhe me rrezik për abuzime. Pa pyetje parlamentare, interpelanca apo raporte, Qeveria në detyrë nuk përballlet me asnjë

kontroll mbi politikat që ndjek, mbi emërimet që bëjnë dhe mbi mënyrën si i menaxhon fondet publike. Kjo situatë dëmton integritetin e procesit vendimmarrës dhe hap rrugën për praktika arbitrare në financa, punësime dhe menaxhimin e pasurisë publike.

Grafiku 1: Ndarja e akteve ligjore të Qeverisë në detyrë sipas llojit, për periudhën 27 mars – 14 korrik 2025



<sup>7</sup> Shih: Ligji Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kapitulli VIII, Neni 28 Përfundimi i mandatit të Qeverisë, Paragrafi 1. Mandati i Qeverisë përfundon: 1.1. Me përfundimin e mandatit katërvjeçar të Kuvendit (në rastin konkret 26 Mars 2025);

<sup>8</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës: Mbledhja Nr. 264/2025; Mbledhja Nr. 263/2025; Mbledhja Nr. 262/2025; Mbledhja Nr. 261/2025; Mbledhja Nr. 260/2025; Mbledhja Nr. 258/2025 dhe Mbledhja Nr. 256/2025



### 3.1 Qeveria në dorëheqje tejkalon kufizimet e përcaktuara me ligjin për Qeverinë

Ligji për Qeverinë përcakton qartë se një qeveri në detyrë mund të trajtojë vetëm çështje të domosdoshme dhe të planifikuara më parë,<sup>9</sup> por gjatë periudhës mars–korrik 2025, janë miratuar 64 akte pa debat publik ose kontroll parlamentar.

Një nga devijimet më serioze në këtë periudhë ishte fenomeni i zyrtarëve që mbanin njëkohësisht funksione të dyfishta si deputetë dhe ministra.

**Kjo shkelje cenon parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve,<sup>10</sup> sepse i njëjti person vepron njëkohësisht si mbikëqyrës (legjislativ) dhe i mbikëqyrur (ekzekutiv). Gjykata Supreme, me një vendim të 7 korrikut 2025 dhe të publikuar më 15 korrik,<sup>11</sup> e ka shpallur të paligjshëm një udhëzim administrativ të nxjerrë nga Ministri i Financave për shkak të këtij konflikti të interesit dhe ka konfirmuar se akte të tilla të ndërmarra në papajtueshmëri mandate, bien ndesh me Kushtetutën.**

Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe janë miratuar vendime për themelimin e komisioneve, komiteteve dhe bordeve,<sup>12</sup> si dhe tetë emërimet në pozita të larta publike. Edhe pse një pjesë e tyre kanë përfunduar procedurën e nisura para përfundimit të mandatit të qeverisë, fakti që të njëjtat – me efekte afatgjata në administratën publike – janë bërë nga një qeveri në detyrë është problematik dhe rrezikon të shihet si hapësirë për emërimet me prapavijë politike.

### 3.2 Mungesa e mbikëqyrjes ndaj zhvillimeve në dialogun me Serbinë

Roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e politikës së jashtme është i përcaktuar me Kushtetutë<sup>13</sup> dhe mbetet jetik për legjitimitetin demokratik të negociatave që po vazhdojnë për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, që nga viti 2011.

Në mungesë të një Kuvendi funksional, procesi i dialogut me Serbinë, që nga përfundimi i mandatit të legjislaturës së kaluar, ka vijuar pa transparencë dhe pa mbikëqyrje. Pas zgjedhjeve parlamentare, janë mbajtur dy takime në Bruksel: më 2 qershor<sup>14</sup> dhe më 10 qershor<sup>15</sup> 2025. Në të dyja rastet, Kosovën e ka përfaqësuar zëvendëskryeministri në detyrë Besnik Bislimi, pavarësisht se Qeveria është në mandat të kufizuar dhe pa legjitimitet të plotë.

Takimet kanë adresuar zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe, potencialisht, hapa të rinj në procesin e dialogut. Por duke qenë se nuk ka Kuvend për të mbikëqyrur këto angazhime, dialogu zhvillohet jashtë kriterëve demokratike bazë si transparenca dhe llogaridhënia. Kjo krijon pasiguri për vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e zotimeve që merren në këtë proces.

<sup>9</sup> Shih, Ligji Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Neni 31 Kufizimet e Qeverisë në dorëheqje

<sup>10</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4 thekson qartë faktin që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë.

<sup>11</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykim në rastin PA. Nr.09/25- datë 7 korrik 2025.

<sup>12</sup> Gjatë kësaj periudhe, Qeveria ka vendosur për themelimin e Komisionit të Ankesave për Shtetësi me mandat trevjeçar, emërtimin e Komitetit Ndërmirator për shëndetin njerëzor, shtazor dhe mjedisor "Një Shëndet" me mandat dyvjeçar, si dhe emërimin e kandidatëve për bord drejtues në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A në Prizren për një mandat trevjeçar.

<sup>13</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 65, pika 9 dhe 12.

<sup>14</sup> Më 2 qershor, Bislimi ka mbajtur një takim me emisarin e ri të BE-së për dialogun, Peter Sorensen, gjatë të cilit është diskutuar lidhur me procesin e dialogut dhe zbatimin e zotimeve. Për më shumë, shih: <https://kallxo.com/lajm/takimi-bislimi-sorensen-a-ka-mandat-zv-kryeministri-ne-detyre-te-zhvilloje-bisedime-ne-bruksel/>

<sup>15</sup> Më 10 qershor, është mbajtur një takim trilateral në Bruksel në të cilin është diskutuar lidhur me zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Për më shumë, shih: <https://indeksonline.net/sorenseni-flet-per-takimin-trepalesh-ne-bruksel/>





4

# CENIMI I INTEGRITETIT DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA DHE BORDEVE PUBLIKE





**Në Kosovë funksionojnë mbi 20 agjenci dhe autoritete të pavarura që raportojnë drejtpërdrejt para Kuvendit. Këto institucione mbulojnë fusha të ndryshme që prekin interesin publik, si mbrojtja e të dhënave personale, mjedisi, energjia, komunikimet, pensionet, trashëgimia kulturore, prokurimi publik, të drejtat e njeriut dhe lufta kundër korrupsionit. Përveç përgjegjësive të tyre funksionale, këto institucione administrojnë së bashku (ndonëse operojnë me buxhete të ndara) rreth 60 milionë euro buxhet publik në vit, gjë që e bën mbikëqyrjen parlamentare jo vetëm të rëndësishme, por jetike për të siguruar transparencë dhe pavarësi të tyre.**

Moskonstituimi i Kuvendit ka bllokuar këtë mekanizëm të mbikëqyrjes. Për muaj të tërë, institucionet kanë vepruar pa asnjë kontroll institucional, duke i lënë vendimarrjet e tyre jashtë vëmendjes së publikut dhe pa debat demokratik. Madje, disa borde dhe organe mbeten jofunksionale për shkak të moszëvendësimit të anëtarëve.

#### 4.1. Raportet vjetore të institucioneve të pavarura – në pritje të shqyrtimit

Një nga funksionet më të rëndësishme të Kuvendit është shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, i cili siguron llogaridhënie dhe mbikëqyrje efektive mbi aktivitetet dhe financat e tyre. Sipas ligjit dhe praktikës, raportet dorëzohen zakonisht në fund muajit mars dhe duhet të shqyrtohen në muajt pasardhës. Megjithatë, për shkak të moskonstituimit të Kuvendit, institucionet nuk kanë pasur mundësi të procedojnë me dorëzimin e raporteve të tyre për vitin 2024, përderisa mungon organi përkatës që i pranon dhe shqyrton ato. Kjo do të thotë që asnjë institucion nuk ka pasur detyrim të japë llogari për punën e tij para përfaqësuesve të qytetarëve.

Kjo situatë i ka bllokuar funksionet normale të llogaridhënies dhe ka shtyrë shqyrtimin e raporteve vjetore që ligjërisht duhet të trajtohen nga Kuvendi. Për më tepër, edhe një pjesë e raporteve për vitin 2023, të cilat ishin dorëzuar dhe ishin në procedurë, nuk u miratuan nga legjislatura e kaluar – duke shtuar barrën e dokumenteve të pashqyrtuara që po akumulohen në mungesë të funksionimit parlamentar. Mostrajtimi adekuat dhe mosadresimi i këtyre raporteve ndikon negativisht në planifikimin dhe prioritetet e

institucioneve për vitet në vijim, sepse ato nuk marrin as miratim, as vërejtje zyrtare për performancën e tyre.



**Për shkak të moskonstituimit të Kuvendit, institucionet nuk kanë pasur mundësi të procedojnë me dorëzimin e raporteve të tyre për vitin 2024, përderisa mungon organi përkatës që i pranon dhe shqyrton ato. Kjo do të thotë që asnjë institucion nuk ka pasur detyrim të japë llogari për punën e tij para përfaqësuesve të qytetarëve.**

16 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 65, pika 9.



Institucionet e pavarura	Shkurtesa	Buxheti vjetor në Euro <sup>17</sup>
1 Agjencia Kosovare e Privatizimit	AKP	5,111,731.00
2 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	AKKVP	2,933,439.00
3 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	APK	1,099,235.00
4 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	AMKMK	6,310,000.00
5 Agjencia për Informim dhe Privatësi	AIP	495,563.00
6 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	ANJF	563,418.00
7 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	ARKEP	1,636,914.00
8 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit	AMM	2,639,311.00
9 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	ARH	436,599.00
10 Autoriteti i Aviacionit Civil	AAC	858,966.00
11 Radio Televizioni i Kosovës	RTK	8,960,000.00
12 Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	FKPK	1,721,100.00
13 Institucioni i Avokatit të Popullit	IAP	1,451,622.00
14 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	KKTK	364,366.00
15 Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	KPMSHC	612,381.00
16 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	KPMM	1,566,882.00

17 LIGJI NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>





Institucionet e pavarura	Shkurtesa	Buxheti vjetor në Euro <sup>17</sup>
17 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	KQZ	22,327,635.00
18 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	KRPP	882,455.00
19 Komisioni i Pavarur i Mediave	KPM	1,386,137.00
20 Organi Shqyrtues i Prokurimit	OSHP	539,193.00
21 Zyra Kombëtare e Auditimit	ZKA	3,532,633.00
22 Zyra e Rregullatorit për Energji	ZRRE	1,148,610.00
23 Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit	ARSHU	504,426.00
<b>Gjithsej</b>		<b>59,037,446.00 Euro</b>

#### 4.2. Rreziku i politizimit dhe keqpërdorimeve brenda institucioneve të pavarura dhe bordeve publike

Moskonstituimi i Kuvendit e bën më të lehtë ndërhyrjen politike në institucione të pavarura dhe në borde publike. Emërimi i ushtruesve të detyrës ose i personave të lidhur politikisht, jashtë procedurave transparente dhe të bazuara në meritë, minon integritetin e institucioneve dhe e shndërron pavarësinë e tyre në formalitet. Pa Kuvend që të mbikëqyrë dhe verifikojë këto emërimet, rreziku degradimit dhe kapjes së institucioneve është real.

Mungesa e kontrollit institucional gjithashtu i bën më të lehta keqpërdorimet financiare. Buxhete të mëdha dhe tenderë publikë mund të shfrytëzohen në mënyrë klienteliste, duke u drejtuar nga interesa të ngushta politike në vend të interesit publik, që rrezikojnë të rezultojnë me punë të realizuara nën standardet e kërkuara dhe pa një mbikëqyrje adekuate. Punësimet gjithashtu rrezikojnë të kthehen në mjete për shpërblime politike, duke u bërë në

funkcion të lojërave të brendshme partiake dhe jo bazuar në meritokraci.

Mungesa e Kuvendit krijon një vakum institucional, duke shkakuar paqartësi në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen në agjencitë e krijuara nga vetë Kuvendi, të cilat në mungesë të Kuvendit mbeten pa një vend ku duhet të raportojnë për punën apo mos punën e tyre. Mungesa e konstituimit të Kuvendit për një kohë më të gjatë mund të ketë pasoja të pariparueshme për këto agjenci, duke minuar llogaridhënien dhe transparencën e tyre. Ky vakum institucional e dëmton seriozisht parimin e ndarjes së pushteteve.



# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kriza aktuale politike dhe institucionale që ka prodhuar moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës përbën një kërcënim ndaj themeleve të rendit kushtetues dhe funksionimit të demokracisë. Shkelja e afatit kushtetues për konstituim, shpërfillja e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe vazhdimi i qeverisjes nga një Qeveri në dorëheqje kanë krijuar një situatë ku shteti i së drejtës, integriteti institucional dhe kontrolli demokratik janë dobësuar ndjeshëm.

#### Moskonstituimi i Kuvendit ka sjellë një varg pasojash konkrete:

- Është minuar ndarja dhe balanca e pushteteve, me një Qeveri në dorëheqje që merr vendime politike, financiare dhe kadrovike përtej mandatit të saj, pa mbikëqyrje dhe pa debat publik.
- Janë bllokuar proceset ligjvënëse dhe reformat thelbësore në drejtësi, duke përfshirë amendamentet për Vettingun, projektligjet e Pakos së Reformës në Drejtësi dhe Kodin Civil, duke penguar kështu përparimin në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e shtetit të së drejtës.
- Është paralizuar funksionimi i institucioneve të pavarura dhe bordeve publike, duke i lënë ato pa mbikëqyrje, pa plotësim të anëtarëve dhe pa trajtim të raporteve vjetore, duke rritur rrezikun për keqmenaxhim dhe ndërhyrje politike.
- Është dëmtuar imazhi ndërkombëtar i Kosovës, me pasoja konkrete në raport me BE-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë, duke vonuar ratifikimin e marrëveshjeve dhe zbatimin e reformave të lidhura me Planin e Rritjes së BE-së dhe procesin e Berlinit.
- Është normalizuar kultura e moszbatimit të Kushtetutës dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke krijuar precedent të rrezikshëm për të ardhmen dhe duke minuar besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Kjo situatë nuk është vetëm krizë politike e përkohshme, por edhe një dështim institucional që po prodhon pasoja afatgjata për qeverisjen e mirë, integritetin institucional dhe aspiratat integruuese të Kosovës.





Bazuar në gjetjet e këtij punimi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ofron rekomandimet e mëposhtme, – në funksion të garantimit të shtetit të së drejtës dhe parimit të ndarjes së pushteteve:

- **Kuvendi i ri duhet t'i japë prioritet miratimit të akteve ligjore të bllokuara që lidhen me sektorin e drejtësisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.**
- **Përforcimi i kornizës ligjore për periudhat tranzitore.** Kuvendi i ri duhet të amendamentojë legjislacionin përkatës për të përcaktuar:
  - detyrimin për auditim ex post të vendimeve të marra gjatë periudhës tranzitore;
  - Afate dhe procedura për anulimin e vendimeve të paligjshme ose arbitrare,
  - kufizime dhe sanksione të qarta për tejkalimet e kompetencave nga një qeveri në dorëheqje.
- **Rishikimi buxhetor dhe përgatitja e buxhetit të ri për vitin 2026 duhet të bëhen nga një Kuvend i konstituuar.**
- **Përmbushja e obligimeve që derivojnë nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.**
- **Auditimi i veprimeve të qeverisë gjatë periudhës së bllokimit.** ZKA duhet të përfshijë në planin vjetor një auditim të vendimmarrjes së qeverisë në tranzicion, dhe Komisionet parlamentare të thërrasin dëgjime me Qeverinë për të mbikëqyrur vendimet e marra.



|||||

|||||

